

OBLIGIMET LIGJORE PËR MBAJTJE TË PËRGJEGJSHME TË KAFSHËVE SHOQËRUESE

Legislacioni i Republikës së Kosovës ka bazë ligjore e cila parasheh përkujdesjen ndaj kafshëve në mënyrë që të sigurohet plotësimi i nevojave fizike, fiziologjike dhe sociale të kafshëve.

Në aspektin ligjor, **termi "kafshë"** nënkupton të gjitha **kafshët e gjalla**, duke përfshirë edhe shpezët, peshqit dhe bletët, larvat që jetojnë të lira dhe format larvare riprodhuese, por pa përfshirë format fetale ose embrionike.

Në Republikën e Kosovës, ekzistojnë **dy akte ligjore** për përkujdesjen dhe mbrojtjen e mirëqenies dhe shëndetit të kafshëve:

LIGJI NR. 02/L-10 PËR PËRKUJDESJEN NDAJ KAFSHËVE **LIGJI NR. 2004/21 PËR VETERINARINË**

Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve i ka në fokus të gjitha çështjet që lidhen me:

- **mbajtjen**
- **kujdesin**
- **strehimin**
- **transportin**
- **mbarëshkrimin**
- **çështje të tjera që lidhen me përkujdesje ndaj kafshëve.**



Ligji për Veterinarinë ka në fokus rregullimin e çështjeve që lidhen me fushën e veterinarisë, përkatësisht shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik, përfshirë masat e kontrollit për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve nga kafshët tek njerëzit apo kafshët tjera.

Nga këto dy ligje, rrjedhin edhe **disa akte nën-ligjore**, që përcaktojnë obligimet dhe rregullat për çështjet si:

- **Identifikimi & Regjistrimi i kafshëve shoqëruese**
- **Kushtet e lëvizjes së kafshëve shoqëruese**
- **Vaksinimin e kafshëve për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve**



PËRKUJDESJA NDAJ KAFSHËVE

Sipas **Ligjit për Përkujdesje ndaj Kafshëve**, çdo person që mban apo kujdeset për çfarëdo kafshe, do të jetë përgjegjës për **sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e kafshës**.

Një nga standardet e pranuar ndërkombëtarisht, është edhe standardi i **"Pesë Lirive"** për mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve: *Liria nga uria dhe etja, Liria nga shqetësimi, Liria nga dhimbjet, lëndimet ose sëmundjet, Liria për të shprehur sjelljet normale, Liria nga frika dhe stresi.*

Legjislacioni në fuqi e ndalon braktisjen e kafshëve shoqëruese apo të vegjëlive të tyre.

IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I KAFSHËVE SHOQËRUESE

Sipas **Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 02/2018 & 02/2021** për **Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese**, pronari/mbajtësi ose personi i autorizuar për përkujdesje të kafshës shoqëruese, është i obliguar që ta bëjë identifikimin e kafshës me **mikroçip** brenda periudhës prej tre (3) muaj nga data e lindjes dhe të bëjë ndërlidhjen e të dhënave të kafshës me të dhënat personale të tij/saj.

TRANSPORTI I KAFSHËVE SHOQËRUESE

Për të udhëtuar/lëvizur me kafshën tuaj shoqëruese brenda dhe jashtë Kosovës, duhet të ndiqen udhëzimet dhe dispozitat ligjore në fuqi, duke përfshirë edhe rregullat e destinacionit ku do të udhëtojë kafsha. *Kafsha duhet të ketë të gjitha vaksinimet e nevojshme të përditësuara, duhet të jetë e identifikuar dhe duhet të posedojë të gjitha certifikatat mjekësore të aprovuara nga autoriteti kompetent.*

MBROJTJA NGA ABUZIMI

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh *dënime me gjobë dhe/ose me burgim* për këdo që me veprim apo mosveprim i shkakton kafshës vuajtje, dhimbje apo shqetësime të rënda.

Sipas **Kodit Penal**, organizimi i luftërave me qen po ashtu përbën veprë penale dhe është i ndaluar.

